



## KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

### EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 1 mars 2016, në mbledhjen e XXV-të  
(njëzetepesë) të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 13.10'.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z. Mehmet Gashi, kryesues i Kuvendit, përkatësisht kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti: Bahri Blakçori, Islam Revuçi, Fidan Rekalu, Haki Rudari, Kadri Avdiu, Kumrie Hoti, Mynavere Abdullahu – Krasniqi, Naim Çunaku dhe Rafet Llapashtica.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Avni Maloku, drejtor i Drejtorisë së Arsimit, Durim Salihu, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Florie Besholli, u.d. e drejtorit të Drejtorisë së Inspeksionit, Agron Hyseni, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Cailean Meclean e Muharrem Haziri, OSBE.

#### 1. Miratimi i rendit të ditës

**Kryesuesi z. Mehmet Gashi**, theksoi, sipas Planit të punës së Kuvendit është dashtë të mbahet një mbledhje në muajin shkurt, por për shkak të përgatitjes së disa materialeve kjo mbledhje është shtyrë për disa ditë, mirëpo gjithsesi do të kujdesemi që të shqyrtohen të gjitha çështjet e planifikuara me planin e punës.

**z. Haki Rudari**, theksoi, nuk kam vërejtje për rendin e ditës por kam vërejtje të Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2016, kur është miratuar ai plan unë kam propozuar që për mbajtjen e mbledhjeve të caktohet edhe data e mbledhjeve ngase sikur të ishte data sigurisht do të ishte një gatishmëri më e madhe e drejtorëve që të përgatisin me kohë materialet, mirëpo tash rezulton se ne në muajin shkurt nuk kemi mbajtur mbledhje, andaj kërkoj që në të ardhmen mos të ndodh që të kalon muaji e të mos mbajmë mbledhje.

**Kryesuesi z. Mehmet Gashi**, theksoi, drejtorët e Drejtorive e kanë Planin e punës së Kuvendit por pavarësisht kësaj unë në vazhdimësi bëj përpjekje t'i informoj për çështjet të cilat do të shqyrtohen në Kuvend.

*Rendi i propozuar i ditës u miratua njëzëri.*

## **2. Shqyrtimi i Ekstraktit të procesverbalit të mbajtur në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa më 28 janar 2016**

*Ekstrakti i procesverbalit u miratua njëzëri.*

## **3. Propozimi i Vendimit të Planit Zhvillimor Komunal për periudhën 2016 – 2025**

**z. Durim Salihu**, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, e paraqiti fjalën hyrëse, me theks që Drejtoria përkatëse është e nevojshme të bëjë korrigjimin e disa lëshimeve teknike dhe gjuhësore.

**z. Fidan Rekaliu**, theksoi, Grupi i këshilltarëve i LDK – së e mbështesim Planin Zhvillimor Komunal dhe jemi të mendimit se ky plan do të ndikoj në zhvillimin ekonomik të komunës.

Sa i përket vërejtjeve disa prej të cilave i përmendi drejtori në fjalën hyrëse, të njëjtat i ka vërejtur edhe Grupi i jonë i këshilltarëve, mirëpo këtë dokument e mbështesim duke u bazuar edhe në fjalën e drejtorit i cili u zotua se vërejtjet do të korrigohen.

**z. Rafet Llapashtica**, theksoi, parafolësi e përmendi se Grupi i LDK – së është takuar dhe e ka shqyrtuar këtë material, mirëpo subjektet politike tjera të përfaqësuara në Kuvend nuk kanë qenë të ftuara, për këtë mund të them se një veprim i këtillë nuk është i mirë.

I vetëdijshëm për rëndësinë e Planit Zhvillimor Komunal për periudhë 10 vjeçare, për të mos humbur kohë, Grupi i këshilltarëve i PDK – së vërejtjet do t'i paraqet në mbledhje të Kuvendit.

**z. Fidan Rekaliu**, theksoi, e drejtë e çdo grupi të këshilltarëve është të takohet para mbledhjeve të Kuvendit në këtë kontekst është takuar edhe Grupi i këshilltarëve të LDK – së dhe në mënyrën e njëjtë ka mund të takohet edhe Grupi i këshilltarëve i PKD – së.

**z. Rafet Llapashtica**, theksoi, absolutisht nuk është e kontestuese e drejta e çdo subjekti politik të takohet, mirëpo unë po bazohem në faktin se në këtë mandat nuk është diskutuar asnjëherë drafti i këtij dokumenti.

Nëse subjektit politik LDK i është dërguar paraprakisht drafti i këtij dokumenti, para dërgimit të materialit për mbledhje të Kuvendit, jam i mendimit se edhe subjektit politik PDK është dashtë t'i dërgohet, mirëpo tani çështja u sqarua.

**z. Fidan Rekaliu**, theksoi, dokumenti për të cilin po debatojmë i është dërguar të gjithë këshilltarëve së bashku me materialin për mbledhjen e Kuvendit të datës 2 mars 2016 dhe pas marrjes së materialit i kemi analizuar çështjet e propozuara për shqyrtim.

**z. Durim Salihu**, theksoi, me vendim të Kuvendit të Komunës në vitin 2009 është iniciuar procedura për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal, ka qenë në diskutime publike në pesë faza dhe në procedurën para miratimit ka ndryshuar Ligji për Planifikimin Hapësinor sipas të cilit është dashtë të merret edhe Pëlqimi mjedisor, arsye për të cilën ky plan nuk është miratuar deri tash.

**z. Haki Rudari**, theksoi, edhe Grupi i këshilltarëve i LVV – së e ka analizuar këtë material, në parim e përkrahim këtë plan, mirëpo konsiderojmë se do duhej që edhe një herë t'i kthehemi debatit me qytetarë ngase edhe drejtori në fjalën hyrëse tha se ka nevojë për korrigjime, andaj sipas akteve nënligjore të komunës do duhej që ky dokument të vihet edhe një herë në debat me qytetarë dhe atë për arsye se është një dokument me rëndësi të veçantë dhe për një periudhë dhjetëvjeçare e për këtë është e domosdoshme të marrim edhe mendimin e qytetarëve.

**Kryesuesi z. Mehmet Gashi**, theksoi, miratimi i Planit Zhvillimor Komunal është obligim ligjor, disa komuna e kanë miratuar e disa jo, mirëpo në kuadër të integriteteve Evropiane komunat të cilat nuk e kanë miratuar këtë plan e kanë një minus.

Në vitin 2009 Kuvendi i Komunës, me miratimin e vendimit, e ka iniciuar procedurën për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal, pastaj e ka ngritur Grupin e ekspertëve të lëmive të ndryshme për ofrimin e ndihmës në hartimin e këtij dokumenti. Gjithashtu në procedurë të tenderimit është përzgjedhë një kompani e specializuar për hartimin e këtij dokumenti.

Në pesë faza të hartimit të Planit Zhvillimor Komunal janë mbajtur debate me qytetarë në të cilat të gjitha strukturat relevante duke përfshirë edhe përfaqësuesit e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Pas hartimit të draftit final, në vitin 2011, është kërkuar pëlqimi për miratim të këtij dokumenti nga ana e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, e cila e ka analizuar draftin dhe në 24 faqe i ka paraqitur vërejtjet e veta, vërejtje të cilat janë inkorporuar në materialin bazë.

Mirëpo për shkak të ndryshimeve ligjore të cilat kanë ndodhë në ndërkohë për miratimin e këtij plani është dashtë të merret edhe Pëlqimi për vlerësim strategjik mjedisor, obligim të cilin komuna e ka përmbush, mirëpo kuptohet për arsye të qëndrueshme kjo çështje ka marrë një kohë të konsiderueshme.

Kohë më parë Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor e ka dhënë pëlqimin për miratimin e këtij dokumenti, Vendimi u është dërguar me material për këtë mbledhje.

U përmend se në këtë dokument janë disa lëshime teknike dhe gjuhësore, lidhur me këtë jam i mendimit se përmes Kuvendit mund ta obligojmë Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit që pas miratimit t'i korrigjoj të gjitha lëshimet e cekura.

**z. Islam Revuçi**, theksoi, të dhënat në këtë dokument për tre sektorët kryesor përkatësisht nga Administrata, Shëndetësia dhe Arsimit nuk përputhen me realitetin e tashëm ngase të dhënat i përkasin periudhës së mëhershme, andaj përveç lëshimeve teknike dhe gjuhësore është e nevojshme të korrigjohen edhe të dhënat përmbajtjesore. U përmend çështja që të obligohet Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit të bëjë korrigjimet e nevojshme, në këtë kontekst jam i interesuar të di se pas përmbushjes së këtij obligimi, Drejtoria e cekur a do të na paraqet Raport për korrigjimet e bëra.

**z. Kadri Avdiu**, theksoi, pajtohem me parafolësin meqë nëse i rekomandojmë kuvendit dhe e miratojmë këtë dokument me gabime dhe lëshime, për një veprim të tillë fajtor jemi ne, mirëpo unë jam i mendimit se Kompania përkatëse së bashku me Ekzekutivin e komunës mund t'i bëjnë korrigjimet e lëshimeve të cilat ne të

gjithë i kemi vërejtur duke filluar nga faqja e parë e këtij dokumenti dhe atë jo vetëm teknike e gjuhësore por edhe përmbajtjesore.

**z. Haki Rudari**, theksoi, jam i mendimit se ne i përfaqësojmë subjektet përkatëse politike, mirëpo jemi duke debatuar për Planin Zhvillimor Komunal për periudhën 2016 – 2025, andaj rëndësia e këtij dokumenti i tejkalon aspektet partiake.

U përmenden vërejtjet në këtë dokument të cilat i kemi vërejtur edhe ne dhe në këtë kontekst, në kuadër të transparencës, konsideroj se do duhej të mbaheshin takime me qytetarë në mënyrë që të konsultohen edhe ata dhe të dëgjohet zëri i tyre, pra para miratimit do duhej të merret edhe mendimi i qytetarëve dhe ekspertëve të lëmive të ndryshme.

**z. Rafet Llapashtica**, theksoi, ne po debatojmë që këtë draft dokument t'ja rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim dhe miratim me vetëdije të plotë se të dhënat statistikore të ndryshme janë të një periudhe para pesë viteve, nëse veprojmë në këtë mënyrë ky Komitet do të bie në pozitë joprofesionale ngase ne po i vërejmë defektet.

Nëse drejtori i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit zotohet se deri nesër në orën 10, së bashku me Kompaninë e cila e ka hartuar këtë draft, i bënë përmirësimet në këtë dokument ne mund t'i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim dhe miratim, mirëpo konsideroj se është shumë vonë dhe është e pamundur të bëhen korrigjimet e nevojshme.

Në një gjendje të këtillë ne grupi i këshilltarëve i PDK – së nuk e mbështesim propozimin që ky dokument Kuvendit t'i rekomandohet për shqyrtim, por edhe sikur ta mbështesim do të mbajmë qëndrimin të cilin e paraqita.

**Kryesuesi z. Mehmet Gashi**, propozoi që ky draft dokument t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, ndërsa në mbledhje të Kuvendit pas debatit të merret qëndrim konkret se si të vendoset.

*Propozimi i kryesuesit u miratua njëzëri.*

#### **4. Propozim Rregullorja për mbrojtjen e të miturve nga dukuritë që dëmtojnë shëndetin dhe zhvillimin e tyre**

##### **- Vendimi për vënie në diskutim publik**

**z. Haki Rudari**, theksoi, në kuptimin e përmbajtjes është një Rregullore e mirë, por sipas mendimit tim është i nevojshëm një aktivitet më i madh i Drejtorisë përkatëse e në veçanti Drejtorisë së Inspeksionit ngase në bazë të vizitave të cilat i kam bërë me kolegët e mi nëpër fshatra të ndryshme e sidomos në qytet kemi hasur në shitore pranë shkollave të mesme ku shiten edhe alkooli edhe duhani etj. , andaj nuk është mirë këtë Rregullore ta kemi vetëm në letër por duhet të merren aktivitetet për zbatimin e saj.

**z. Rafet Llapashtica**, theksoi, propozimi kësaj Rregulloreje na është dërguar në formën sikur kjo të miratohet në mbledhjen e nesërme të Kuvendit, pra nuk na është dërguar në formën e propozimit për diskutim, përkatësisht propozim që Kuvendit t'i rekomandohet për vënie në diskutim publik.

**z. Islam Revuçi**, theksoi, në kuadër të Drejtorisë së Inspeksionit janë inspektor të lëmive të ndryshme, andaj do të ishte mirë që në dispozitën ku përcaktohet përgjegjësia për zbatimin e kësaj Rregulloreje të definohej saktësisht përgjegjësitë e inspektorëve përkatës.

**z. Bahri Blakçori**, theksoi, Grupi i këshilltarëve i LDK-së e përkrahë propozimin e kësaj Rregulloreje dhe është i mendimit se me rëndësi është që së pari të përcaktohet përmbajtja dhe të miratohet Rregullorja e pastaj të ndërmerren aktivitetet e nevojshme për zbatimin e saj.

**Kryesuesi z. Mehmet Gashi**, propozoi që krahas rekomandimit për shqyrtim Kuvendit njëherit t'i rekomandohet që debati të zgjatë 30 ditë, ndërsa debati publik me qytetarë të mbahet me 23 mars në orën 10,00.

*Propozimi i kryesuesit u miratua njëzëri.*

## **5. Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi**

- **Informatë për aktivitetet në vitin 2015**
- **Plani i punës për vitin 2016**

**z. Rafet Llapashtica**, theksoi, Kryetari i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, në bazë të Udhëzimit Administrativ përkatës është i obliguar që në Kuvend të raportoj dy herë në vit për gjendjen e sigurisë në komunë, mirëpo vitin e kaluar asnjëherë nuk është raportuar për këtë çështje, pra nuk e ka kryer një obligim ligjor.

Disa herë kemi debatuar për çështjen e Kompanisë KEDS të cilës edhe pse është kompani private i është dhënë në shfrytëzim paluajtshmëri në pronësi të komunës për vendosjen e trafave dhe atë pa kompensim, në këtë kontekst kam një pyetje e ajo ka të bëjë me atë se Kompanisë së cekur a i është dhënë leje për vendosjen e njehsorëve të energjisë elektrike në shtylla të rrjetit elektrik në rrugën e cila shpie për fshatin Letanc, formë e cila edhe në këtë Informatë parashihet e paligjshme, andaj shtrohet pyetja çfarë është ndërmarrë nga Drejtoria e Inspeksionit në këtë drejtim. Sipas mendimit tim forma e tillë e vendosjes së njehsorëve elektrik duhet të ndërpritet. Gjithashtu ajo Kompani vendos shtylla të betonit kur dihet se rrjeti i energjisë elektrike duhet të jetë nëntokësor.

**z. Durim Salihu**, theksoi, KEDS – i për vendosjen e njehsorëve të energjisë elektrike në shtylla të rrjetit elektrik nuk ka marrë leje nga Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, për këtë kemi pasë polemika të ashpra me përfaqësuesit e Kompanisë së përmendur, ngase ata të drejtën e cekur e mbështesin në një marrëveshje të lidhur me Nivelin qendror.

**z. Haki Rudari**, theksoi, kohë më parë në mbledhje të Kuvendit e kam ngritur çështjen se në bazë të nenit 10 të Udhëzimit Administrativ përkatës Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi është i obliguar që Kuvendin ta informoj dy herë në vit për punët dhe aktivitetet e Këshillit.

Sipas Planit të punës së Kuvendit parashihet që ky Këshill të paraqet informatën për gjashtëmujorin e parë të viti 2016 dhe besoj se do të respektohet ky obligim.

Sa i përket vendosjes së njehsorëve elektrik në shtylla për këtë kemi diskutuar edhe në Kuvend, çështje për të cilën ka ankesa të shumta nga qytetarët për shkak të rrezikshmërisë që paraqesin për fëmijë, andaj Drejtoritë kompetente kësaj çështjeje duhet t'i qasen me seriozitetin më të madhe, në mënyrë që mos të kemi ndonjë rast me fatalitet siç ka ndodh në komunën e Gjakovës.

Konsideroj se në Kuvend do duhej të kemi Informatën për sigurinë në komunikacion duke përfshirë edhe sigurinë në shkolla, ngase kemi shumë ankesa nga drejtorët e shkollave e në veçanti nga drejtorët e shkollave të mesme.

Gjithashtu është e nevojshme që në Kuvend të paraqitet edhe informata për të riatdhesuarit përkatësisht të kthyerit nga shtetet e ndryshme.

Në përgjithësi mund të themi se është neglizhuar funksioni i këtij Këshilli edhe pse ka një funksion tepër të rëndësishëm dhe serioz ngase e kam përcjellë punën e disa Kuvendeve të komunave tjera në të cilat Komandanti i Policisë ka raportuar për gjendjen e sigurisë në komunat përkatëse, derisa ne jemi në vitin e tretë të këtij mandati dhe asnjëherë nuk e kemi pasë ndonjë informatë nga ky Këshillë apo nga Komandanti i Policisë për gjendjen e sigurisë në komunë.

**z. Faik Muçiqi**, theksoi, ky Plan i punës është i KKSB – së nuk e mohon të drejtën që Kuvendi i komunës të shqyrtoj edhe çështjet të cilat i ngriti parafolësi.

Komandanti i Policisë është i rregullt në mbledhjet e këtij Këshilli dhe raporton çdo herë për temat e përhershme, mirëpo KKSB nuk mundet me obliguar Komandantin e Policisë që të raportoj edhe në Kuvend.

*Pas votimit u konstatua se Informata për aktivitetet në vitin 2015 dhe Plani i punës për vitin 2016 i KKSB – së, Kuvendit njëzëri i rekomandohen për shqyrtim.*

## **6. Plani i veprimit për transparencë në komunën e Podujevës për vitin 2016**

**Kryesuesi z. Mehmet Gashi**, e paraqiti fjalën hyrëse.

*Pas votimit u konstatua se Kuvendit, njëzëri i rekomandohen për shqyrtim.*

## **7. Komiteti për Komunitete**

- **Raporti i punës për vitin 2015**
- **Plani i punës për vitin 2016**

*Kuvendit, njëzëri i rekomandohen për shqyrtim.*

## **8. Propozimi i Vendimit për bartjen e të hyrave vetanake të komunës së Podujevës nga viti 2015 në vitin 2016 dhe destinimin në kategori të caktuara buxhetore**

**z. Isuf Latifi**, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, e paraqiti fjalën hyrëse.

**z. Rafet Llapashtica**, theksoi, kemi të bëjmë me ridestnim të mjeteve buxhetore mbi 400.000 € me propozim për destinim në projekte përkatëse, mirëpo konsideroj se ka qenë obligim të sillen të dhënat se këto mjete ku kanë qenë të destinuar në vitin 2015 ngase një numër i projekteve janë miratuar në Kuvend. Kur e them këtë nuk mendoj në të hyrat vetanake të arkëtuara në dhjetor të viti 2015, por jam i bindur se shumica e gjithmbarshme e propozuar për ridestnim nuk është arkëtuar vetëm në dhjetor të vitit të kaluar.

Në emër të Grupit të këshilltarëve të PDK – së kërkoj që për mbledhjen e nesërme të Kuvendit të na paraqiten të dhënat se ku kanë qenë të planifikuara vitin e kaluar mjetet përkatëse, mirëpo nëse nuk kanë qenë të planifikuara atëherë është përgjegjësi e Ekzekutivit.

Jemi në dijeni se pagat e të punësuarve paguhen nga kodi i pagave dhe mëditjeve të buxhetit të komunës, mirëpo ne kemi fakte se në sektorin e arsimit është një rast që paguhet nga mjetet e të hyrave vetanake, për këtë është e nevojshme që Ekzekutivi të jep sqarime, përfundoi ky diskutues.

**z. Haki Rudari**, theksoi, fillimisht do theksuar se të mbeten pa shfrytëzuar mbi 400.000 € të pashfrytëzuara në vitin paraprak, kjo nuk është mirë dhe nuk është serioze nga ana e qeverisjes komunale, kur dihet se qytetarët kanë nevoja të shumta, andaj kur ka mjete e nuk shfrytëzohen, kjo nuk është në rregull.

Nuk mu dha përgjigjja nga Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave e as nga drejtori i Drejtorisë së Arsimit se në rastin e shkollave a kemi të bëjmë me renovim, zgjerim apo ndërtim të shkollave, ngase këto janë tri çështje të ndryshme.

Ka raste kur qytetarët i përgatitin projektet zbatuese ndërsa Drejtorja e Planifikimit urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit nuk i realizon ato projekte e në anën tjetër teprojnë mjete buxhetore.

Gjithashtu shumë herë e kam ngritur çështjen e ofrimit të ndihmës bujqve mirëpo edhe në këtë drejtim nuk është duke u ndihmuar mjaftueshëm.

Janë më shumë se 12 punëtor të cilëve iu bëhet pagesa në bazë të kontratës mbi vepër, çështje e cila përmendet edhe në Raportin e Auditorit, e kjo është shkelje ligjore, andaj kjo nuk duhet të përsëritet.

Te Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, sipas informatave që i kam, stafit punues nuk iu bëhet pagesa për orët e kujdestarisë, ndërsa në këtë material po e vërej se janë 3.351 €, andaj konsideroj se më së miri do të ishte me këto mjete të bëhet pagesa e cekur.

**z. Naim Çunaku**, theksoi, u përmend nga drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave se gjatë përgatitjes së propozimit për ridestinimin e mjeteve përkatëse e ka pasë një konsultim me shefat e grupeve të këshilltarëve dhe të gjithë i përgëzoj se nga afro 500.000 € kanë arritur që t'i destinojnë 5.000 në fondin e një Kuvendi i cili përbëhet prej 35 këshilltarëve duke mos e llogaritur edhe numrin e stafit të Zyrës së Kuvendit.

**z. Kumrie Hoti**, theksoi, fillimisht e përshëndes drejtoreshën e re të Drejtorisë së Inspeksionit ngase kjo do të thotë se më në fund kemi nisur me u vetëdijesuar si komunë. Pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe atë: më intereson të di se a është i informuar se laboratorin në QKMF prej muajit dhjetor, nuk jam e sigurt se a bëhen të gjitha analizat, por ka mungesë të një preparati reagensë. Për këtë arsye në QMF në Kërpimeh është marr edhe laborantja, dua të di pse me këto paga nga mallrat dhe shërbimet, a është i informuar. Do me thënë në QMF nuk punon laboratorin për shkak se nuk ka material, kur e dimë se këto mjete janë dhe a mundemi me shpresuar se do të silltet materiali dhe do të kthehet laborantja në vendin e punës në Kërpimeh, mos me i bartë pacientët. Kur do të bëhet furnizimi i QMF – së në Kërpimeh me material përkatës. Pra pse duhet ne të kemi këtë problem kur ekziston laboratorin kurse nuk ka material.

**z. Isuf Latifi**, u përgjigj për çështjet e paraqitura gjatë diskutimeve me sqarime detaje për mjetet e mbetura të pashfrytëzuara në kode ekonomike dhe projekte konkrete si dhe për shumën e mjeteve të arkëtuara në fund të vitit të cilat për shkak të procedurave të parapara me dispozita ligjore nuk kanë mundur të shfrytëzohen.

**z. Agron Hyseni**, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, theksoi, prej 1 dhjetori 2015 e deri më sot, aparati rëntgen në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, mund të jenë më së shumti mund të jenë pjesërisht tri ditë kohë që nuk ka punuar aparati i cekur dhe atë për shkak të mungesës së materialit përkatës, mirëpo lirshëm mund të them se ai aparat funksionon me kapacitet të plotë.

Sa i përket laborantes në QMF në Kërpimëh, kjo pyetje do duhej t'i shtrohej drejtorit të QKMF – së në Podujevë i cili është përgjegjës për çështjet kuadrove në njësitë përkatëse të shëndetësisë.

*Kuvendit, njëzëri i rekomandohen për shqyrtim.*

**Mbledhja përfundoi në orën 14.35'**

**Procesverbalin e mbajti  
Faik Gashi**

**Nr. 01- 006-17141  
Podujevë,  
1 mars 2016**

**Kryesuesi i Komitetit  
Mehmet Gashi**